

# RELACION

## MBI

### PROJEKTVENDIMIN

#### PËR KRITERET E VENDOSJES DHE TË FUNKSIONIMIT TË STACIONEVE SEZONALE TË ANKORIMIT/BREGËZIMIT

#### I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi, i bashkëpropozuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ka për qëllim përcaktimin e kritereve të vendosjes dhe funksionimit të stacioneve sezonale të ancorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, në vijën bregdetare dhe vijën bregliqenore të Republikës së Shqipërisë, me synim zhvillimin e kësaj infrastrukture dhe rritjen e aktivitetit të bregëzimit.

Objektivi që synohet të arrihet përmes miratimit të këtij projektvendimi dhe zbatimit të tij, është:

- i. stabilizimi i një infrastrukture mbarëkombëtare detare, të ndërmjetme, që krijon kushtet e zhvillimit dhe rritjes së lundrimit turistik;
- ii. bregëzimit në çdo destinacion turistik, duke lehtësuar aksesin pranë burimeve turistike;
- iii. krijimi i mundësive për rritje të përfitimeve ekonomike nga banorët lokalë, bizneset dhe institucionet.

Përgjatë përgatitjes së këtij akti është mbajtur në konsideratë eksperiencia e deritanishme nga zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi dhe praktika të ngjashme nga vende si Italia.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, pasi buron nga përcaktimet e Ligjit 43/2020, datë 23.04.2020 “Për aktivitetet e turizmit detar” dhe është në

përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave, në kuadër të zhvillimit të industrisë së turizmit.

Industria e turizmit ka kontribut të madh në ekonomi në terma monetarë dhe në ato të punësimit. Në programin e saj, qeveria synon të nxisë diversifikimin e turizmit si një instrument që siguron një shfrytëzim më të mirë të burimeve, ofertë turistike gjithëvjetoje, shpërndarje të kërkesës turistike më të balancuar duke shmangur efektet negative të mbipopullimit të destinacionit, por edhe një shpërndarje të të ardhurave më të drejtë duke adresuar çështje të zhvillimit ekonomik.

Rritja e mundësive të shfrytëzimit të ekonomisë detare duke rritur dhe përmirësuar infrastrukturën e ankorim/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, është në përputhje me prioritetin për të zhvilluar “ekonominë blu”.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektvendimi është në përputhje me Planin e Përgjithshëm Analitik të hartimit të akteve ligjore/nënligjore për vitin 2022.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në zbatim të ligjit 43/2020, datë 23.04.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, ky projektvendim përcakton kriteret e vendosjes dhe funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, në vijën bregdetare dhe vijën bregliqenore të Republikës së Shqipërisë.

Ai synon të çlirojë potencialin dhe të nxisë investitorët në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së bregëzimit të mjeteve lundruese turistike dhe zhvillimit të një infrastrukture miqësore me ambientin. Në të njëjtën kohë me këtë synohet të kënaqet kërkesa në rritje e konsumatorit të shërbimeve turistike për udhëtime detare dhe vizita në destinacione të bregdetit shqiptar.

Ky projektvendim përcakton nevojën dhe vendos kushte për të zhvilluar aktivitete dhe shërbime, që garantojnë rritje të cilësisë dhe sigurisë për konsumatorët.

Zhvillimi i kësaj infrastrukture do të nxisë bregëzimin dhe kohëzgjatjen e bregëzimit, përdorimin më të gjerë të mjeteve detare në zinxhirin e shërbimeve turistike në bregdet, duke siguruar rritjen e konsumit të produkteve dhe shërbimeve lokale.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**



Projektvendimi është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr.43/2020, datë 23.04.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”.

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT:

Nëpërmjet këtij projektvendimi propozohet të miratohen kriteret për vendosjen dhe funksionimin e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit në vijën bregdetare dhe vijën bregliqenore të Republikës së Shqipërisë.

Projektvendimi përcakton subjektet që duhet ta zbatojnë atë, si dhe përcakton rregullin e vendosjes së infrastrukturës vetëm në zonat e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT-ja).

Projektvendimi siguron gjithashtu prioritizimin e investimeve strategjike sipas ligjit nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, përkundrejt çdo kërkesë tjetër për zhvillim.

Në projektvendim janë parashikuar kriteret teknike për stacionet sezonale të ankorimit/bregëzimit, që përfshijnë fortësinë strukturore, mbrojtjen e mjedisit, furnizimin me energji elektrike dhe ndriçimin, furnizimin me ujë të pijshëm dhe industrial, shërbimet higjienike, shërbimet mjekësore, trajtimin e mbetjeve dhe sinjalistikën detare.

Më tej, në vendim është parashikuar si mënyrë funksionimi e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit në vijën bregdetare dhe vijën bregliqenore, dhënia me qira, përkundrejt shprehjes së interesit, duke parashikuar afatet e dhënies me qira të pronës së paluajtshme shtetërore për zhvillimin e këtyre projekteve, tarifat minimale dhe administrimin e tyre.

Vlerësimi i kërkesës për zhvillimin e veprimtarisë në hapësirën detare dhe pronën e paluajtshme shtetërore në funksion të zhvillimit dhe funksionimit të



stacionit sezonal të ancorimit/bregëzimit bëhet nga një komision, i cili ka në përbërje jo më pak se 5 persona, specialistë të fushës, nga AKB, AZHT, DPD, MTM, MIE dhe drejtohet nga përfaqësuesi anëtar i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Dhënia me qira do të finalizohet më nënshkrimin e kontratës sipas kontratës tip të miratuar me urdhër të Ministrit dhe do të nëshkruhet ndërmjet AKB-së dhe subjektit fitues.

Kompetencën për funksionimin e stacioneve sezonale të ancorimit/bregëzimit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e realizon nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit në mbështetje të dispozitave të ligjit Nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ku konkretisht në shkronjës dh), pika 2, neni 32 të tij është përcaktuar shprehimisht se: Ministria përgjegjëse për turizmin me anë të strukturave të veta vartëse, administron dhe menaxhon përkatësisht:

- i. turizmin detar dhe bregdetar në Republikën e Shqipërisë;
- ii. ndërtime publike dhe private në vijën bregdetare dhe atë detare të lidhura me veprimtarinë e turizmit.

Gjithashtu Agjencia Kombëtare e Bregdetit është ngarkuar me përgjegjësinë e nënshkrimit të kontratës së qirasë nëpërmjet këtij projektvendimi, bazuar edhe në VKM nr. 569, datë 17.7.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Agjencia Kombëtare e Bregdetit e shtrinë veprimtarinë e saj në të gjithë brezin bregdetar të Republikës së Shqipërisë. Nisur edhe nga objektivat e veprimtarisë kjo Agjenci ofron garanci për zbatimin e projekteve të qëndrueshme, mbrojtjen e brezit bregdetar si dhe peisazhin natyror që përfaqëson, për të kthyer në shërbim të turistëve, edhe vetë të qytetarëve shqiptar si edhe ndjek dhe respekton rregullat mbi përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare.

Në projektvendim është përcaktuar gjithashtu dokumentacioni administrativo ligjor, teknik, mjedisor dhe financiar, procedura e vlerësimit, afatet, të nevojshme për tu zbatuar gjatë procesit të aplikimit për stacionin sezonal. Projektvendimi përcakton terma specifike që duhet të mbahen në konsideratë përgjatë hartimit të kontratës së qirasë me subjektin zhvillues si dhe përcakton shërbimet që ofrohen në stacionet e ancorimit/bregëzimit, përfshirë periudhën minimale të funksionimit të tyre.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ancorimit/bregëzimit”

Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për transportin, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

#### VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

#### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**Belinda Balluku**

**MINISTRI I TURIZMIT  
DHE MJEDISIT**

**Mirela Kumbaro Furxhi**